



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2022:061168

Datë: 23.09.2024

Numri i dokumentit: 06196918

K.DH.SH.II.nr.761/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Beni Dona Plast” shpk, me numër Unik identifikues 810545981 me seli ne Prishtinë rr. “Imzot Nikë Prela” pn, Lagja Ulpianë, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Samir Morina avokat ne Prishtinë, ndaj debitorit Ministria e Punëve te Brendshme me seli ne Prishtinë, te cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1077/23 dt.15.01.2024, me datën 23.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Ministria e Punëve te Brendshme me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1077/23 dt.15.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1077/23 dt.15.01.2024, ne pjesën e I te dispizitivit ka pranuar si pjesërisht të bazuar prapësimin e debitorit Ministria e Punëve te Brendshme dhe urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.211/2022 dt.16.03.2022 te Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi shfuqizohet për shumën prej 465.62 euro dhe për këtë pjesë te përmbarimit procedura përfundohet, ndërsa ne pjesën II te dispozitivit e ka refuzuar si pjesërisht te pabazuar prapësimin e debitorit Ministria e Punëve te Brendshme, ashtu qe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.211/2022 dt.16.03.2022 te Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi për shumën e detyrimit prej 1,848.93 euro.

Kundër këtij aktvendimit, ka ushtruar ankesë debitori, për shkak shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës përmbarimore, vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta miratoj te bazuar ankesën e debitorit dhe ta shfuqizoj aktvendimin e atakuar pjesërisht vetëm sa i përket pikës se dytë te dispozitivit.

Përgjigje ndaj ankesës se debitorit ka ushtruar kreditori, propozon qe gjykata e shkalles se dytë ta lë ne fuqi urdhrin përmbarimor, te detyrohet debitori te paguaj kamatën ligjore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkalles se Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Beni Dona Plast” shpk, me numër Unik identifikues 810545981 me seli ne Prishtinë rr. “Imzot Nikë Prelaj” pn, Lagja Ulpianë, me datë 15.03.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Ministria e Punëve te Brendshme me seli ne Prishtinë, në bazë të dokumentit te besueshëm- Faturave si ne propozimin për përmbartim. Përmbartuesi Privati Isa Gacaferi, duke vepruar sipas propozimit për Përmbartim nga ana e kreditorit, ka nxjerr urdhrin P.nr.211/22 dt.16.03.2022, me te cilin ka obliguar debitorin qe ne emër te borxhit nga faturat kreditorit ti paguaj shumen prej 2,314.55 euro, me kamatë ligjore prej 8% dhe shpenzimeve te procedurës.

Ndaj këtij urdhri, me dt.23.03.2022, prapësim ka paraqitur debitori, me arsyetimin se ka paguar shumen prej 415.69 euro ndërsa ne proces për pagesë është vlere prej 1,237.51 euro ndërsa faturat te cilat ende nuk janë pranuar nga MPB qenka vlere prej 661.35 euro. Propozon qe gjykata ta miratoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbartimor ta shfuqizoj dhe te hiqen te gjitha veprimet e ndërmarra.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datën 25.03.2022, me arsyetimin se pagesat e bëra janë bere pas i qe është përpiluar propozimi për përmbartim, propozon qe gjykata ta hedh prapësimin e debitorit, ta aprovoj propozimin për përmbartim dhe urdhrin përmbartimor, ta detyroj debitorin te paguaj kamatën ligjore dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe shpenzimet tjera .

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, pas prapësimit te debitorit dhe përgjigjes ne prapësim, ka marrë aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1077/23 dt.15.01.2024, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit si të bazuar dhe ka lenë ne fuqi pjesërisht urdhrin përmbartimor, ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka lenë pjesërisht urdhrin përmbartimor ne fuqi, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit. Gjykata ne vendimin e saj i referohet nenit 29 par.1, nenpar.1.3 dhe par.3 dhe nenit 37 te LPP. Gjykata ka konstatuar se është përmbushur borxhi ne shumen prej 465.62 euro nga totali prej 2,314.55 euro dhe se për këtë konform nenit 71 par.1 nenpar.1.2 te LPP urdhri përmbartimor për shumen e paguar është bere i pa efekt, dhe konform nenit 66.4 te LPP gjykata përfundon procedurën përmbartimore për këtë pjesë. Gjykata ka vendos si ne pjesën e II te dispozitivit për shumen prej 1,848.93 euro pasi qe faturat ne baze te cilave është lejuar përmbartimi i plotësojnë kushtet për te qene dokument i besueshëm dhe përmbajnë e te gjitha elementet e kërkuara konform nenit 29.3 te LPP, faturat janë dorëzuar ne origjinal dhe janë te përshtatshme për përmbartim. Gjykata vlerëson se debitori nuk ka ofruar asnjë prove konform nenit 69 par.4 te LPP sepse nuk ekziston asnjë nga shkaqet e nenit 71 te LPP , ashtu qe ne kuptim te nenit 73 te LPP ka vendos edhe si ne dispozitiv te vendimit te saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim në shkresat e lëndës

qartë konstatohet se faturat mbi bazën e te cilave është lejuar përmbartimi i plotësojnë kushtet për te qenë dokumente te besueshme konform nenit 29 par.3 te LPP i cili parasheh qe se “*Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*”, sepse ne rastin konkret këto fatura janë te nënshkruara nga debitori ashtu qe edhe konsiderohet se janë pranuar ne mënyrë te rregullt nga i njëjti, përmbajnë te gjitha te dhënat për palët ne procedure si dhe elementet tjera te kërkuara me dispozita ligjore, andaj si te tilla plotësojnë kushtet ligjore për tu ekzekutuar.

Edhe kjo gjykate vlerëson përfundimin juridik te gjykatës se shkalles e pare e cila i referohet nenit 37 te LPP i cili përcakton se “*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”, sepse faturat janë bashkëngjitur ne origjinal propozimit për përmbartim.

Në rastin konkret Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe e as ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kjo gjykatë ka analizuar provat e ofruara me ankesë nga debitori ne lidhje me përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, por ne këtë rast vlerëson nenin 180 par.1 te LPK i cili parasheh qe “*Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t’i paraqesë, përkatësisht t’i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë*, prandaj vlerëson vendosjen e gjykatës se shkalles e parë lidhur me çështjen, ndërsa analizon edhe pretendimet ankimore por vlerëson se ne raport me gjendjen faktike tani më këto pretendime nuk janë relevante, ashtu qe te njëjtat i refuzoi ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.761/24, me datë 23.09.2024

Gjyqtari
Ramush Bardiqi